




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 362/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: NT “SPORTING” - Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE: NTP “Vlora”– Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me rekuizita sportive për shkollat e Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-18-008-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më datë: 10.08.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik: NT “SPORTING” - Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me rekuizita sportive për shkollat e Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-18-008-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. VËRTETOHET njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Furnizimi me rekuizita sportive për shkollat e Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-18-008-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: NT “SPORTING” - Prizren, refuzohet, te njëjtit operator ekonomik i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 05.02.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt:08.03.2018, ku kanë marrë pjesë pesë (5) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik: NT “SPORTING” - Prizren, tenderues i pasuksesshëm nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 04.07.2018.

Njoftimi për dhënien e kontratës nga Autoriteti Kontraktues është bërë me dt: 09.07.2018.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatorët ekonomik: NT “SPORTING” - Prizren, me dt: 17.07.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 17.07.2018, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: NT “SPORTING” - Prizren, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: NT “SPORTING” - Prizren, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 24 Korrik 2018, me nr. 362/18, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Furnizimi me rekuizita sportive për shkollat e Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-18-008-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59, 68, 69, 81, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 27.07.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-profesional, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 06.08.2018, sqaron:

Eksperti shqyrtues pasi që ka analizuar shkresat e këtij aktiviteti të prokurimit sqaron që OE ankues pas pranimit të letrës standarde të tenderuesit të eliminuar me datë 04.07.2018 (konfirmimi për datën e dërgimit të letrës standarde për tenderuesin e eliminuar është pranuar përmes postës elektronike nga AK), ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 17.07.2018. Eksperti po ashtu sqaron se AK ka vendosur që të refuzoj Kërkesën për rishqyrtim të OE “NP SPORTING” me seli në Prizren me datë 17.07.2018 pasi që Kërkesa është parashtruar pas afatit të paraparë në Udhëzuesin Administrativ të Prokurimit Publik. Pas pranimit të Vendimit të AK-së, OE ankues me datë 24.07.2018 ka deponuar Ankesë pranë OSHP-së.

Eksperti shqyrtues, sqaron se Kërkesa për rishqyrtim e OE ankues “NP SPORTING”, e dërguar pranë AK është e jashtafatshme, pasi që data e njoftimit të OE ankues me ka qenë me 04.07.2018 dhe Kërkesa për rishqyrtim ka qenë me datë 17.04.2018 e që i bie në ditën e 13-të (trembëdhjetë) Sipas dispozitave të LPP dhe RrUOPP, kalkulimi i afateve kohore fillon me ditën zero nga pranimi i vendimit të AK-së, e që në rastin konkret dita zero është ditë e mërkurë e datës 04.07.2018 si ditë e dërgimit të letrës standarde ndërsa dita e dërgimit të Kërkesës për rishqyrtim pranë AK është ditë e mërkurë e datës 17.07.2018.

Ditët	Data	Dita / Numërimi
E mërkurë - Data e dërgimit të letrës standarde tek OE	04.07.2018	0
E enjte	05.07.2018	1
E premte	06.07.2018	2
E shtunë	07.07.2018	3
E diele	08.07.2018	4
E hënë – Data e fundit e lejuar për parashtrim të Kërkesës për rishqyrtim	09.07.2018	5
E martë	10.07.2018	6
E mërkurë	11.07.2018	7
E enjte	12.07.2018	8
E premte	13.07.2018	9
E shtunë	14.07.2018	10
E hënë	15.07.2018	11
E martë	16.07.2018	12
E mërkurë - Data e Kërkesës për rishqyrtim nga OE	17.07.2018	13

Sipas tabelës së dhënë, dita e fundit për parashtrim të Kërkesës për rishqyrtim ka qenë data 09.07.2018 ditë e hënë. Andaj, duke u nisur nga kjo, Eksperti sqaron se Ankesa në OSHP duhet të hudhet poshtë si e palejuar pasi që Kërkesa për rishqyrtim është e jashtafatëshme.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të hudhet poshtë si e palejuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimin e sipërpërmendur nr. 1), dhe të mbetet në fuqi Njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së.

Autoriteti Kontraktues – Komuna Prishtinë, me datë: 07.08.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: NT "SPORTING" - Prizren, me datë: 06.08.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 10.08.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Vertopi deklaroj: Kompania Sporting nuk pajtohet me konstatimin e ekspertit shqyrtues duke konsideruar raportin jo ligjore, subjektiv, tendencioz dhe ashtu i konsiderojmë pohimet e znj.Prebreza që ankesa të hedhet poshtë për arsye se kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar sipas afatit administrativ ashtu siç kemi argumentuar ligjërisht në ankesë. Sporting ripotencon faktin se njoftimi për dhënie të kontratës është publikuar me datë 09.07.2018 në portalin e KRPP. Në pajtim me nenin 4.1 paragrafi B të rregullave të reja për parashtrimin e ankesave, afati pesë ditor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim fillon të llogaritet pas datës së publikimit të këtij njoftimi. Ashtu siç parashihet me këto rregulla të reja, dita e fundit të parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e Sporting është 14.07.2018 e që i bie ditë e shtunë. Andaj kur dit fundit bie në ditë pushimi, atëherë sipas legjislacionit aktual kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet në ditën pasuese dhe zyrtare të punës, e që i bie 16.07.2018 e që është ditë e hënë. Në këtë datë OE Sporting ka deponuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK me email. Duke u nisur nga faktet e lartcekura kërkesa e OE Sporting dorëzuar në AK është e ligjshme dhe e afatshme në bazë të afateve administrative ashtu siç parashihet sipas nenit 4.1 par.B i rregullave të reja për

parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim. OE e konsideron të paligjshëm dhe në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit që OE Vlora i shpallur fitues i tenderit nga AK edhe pse ky OE nuk ka ofruar kontrata dhe referenca për furnizime të njëjta që janë të realizuara dhe përfunduara në tri vitet e fundit 2015-2016-2017 në vlerë 75,000€. Gjithashtu OE i shpallur fitues ka dorëzuar kopjen e kontratës të datës 12.12.2017 dhe kopjet e faturave për dorëzim të mallit, muajit Mars 2018 të kësaj kontrate publike që është në implementim e sipër. Po ashtu i njëjti OE ka dorëzuar si kopje të kontratës kornizë të vitit 2017 me KK Klinë për një afat tre vjeçar që përfundon në vitin 2020. Këto kontrata kontestuese në asnjë rrethanë ligjore nuk mund të llogariten të realizuara dhe të përfunduara dhe si të tilla duhet të refuzohen dhe oferta e këtij OE të shpallet e papërgjegjshme. Këto dy kontrata kontestuese nuk mund të konsiderohen dëshmi ligjore dhe relevante ngase janë në kundërshtim me kërkesat dhe kushtet themelore që AK ka kërkuar nga OE pjesëmarrës të dorëzojnë kontrata për furnizime të njëjta të përfunduara të implementuara dhe të realizuara për periudhën 2015-2017. Në fund OE Sporting pajtohet plotësisht me deklaratën e dhënë të z. Makolli në seancën e datës 30.05.2018 sepse në mënyrë ligjore dhe profesionale dhe me fakte konkrete tregon se pse OE Vlora është i papërgjegjshëm dhe nuk ka plotësuar kushtet dhe kërkesat e AK. I propozojmë panelit shqyrtues që pas shoshitjes së fakteve dhe argumenteve të konstatoi që OE i rekomanduar Vlora nuk i ka përmbushur kushtet themelore të AK të kërkuara sipas nenit 9.1 dhe 9.2 të dosjes ngase nuk ka ofruar kontrata dhe referenca të realizuar dhe përfunduara në tri vitet e vitit në vlerë 75.000€ dhe që lënda të kthehet në rivlerësim.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK znj. Sekiraqa e cila deklaroj: AK pajtohet me mendimin e ekspertit që lënda e ankuesit të hedhet poshtë si e palejuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për dhënie të kontratës. AK e konsideron të jashtë afatshme kërkesën për rishqyrtim të OE ankues. Sipas UOPP-së përcaktohet se në rast se nuk përputhen data e njoftimit me letër standarde, dhe data e publikimit të njoftimit për dhënie, atëherë vlen data e njoftimit përmes letrës standarde. Letra standarde në këtë rast është dërguar me 04.07.2018. Kërkesa për rishqyrtim është parashtruar në ditën 13 me 16.07.2018. AK pas pranimit të kërkesës menjëherë ka shqyrtuar atë dhe e ka refuzuar kërkesën për shkak se ka qenë jashtë afatit ligjorë për parashtrimin e ankesës. Lidhur me pretendimet për referenca i shohim të panevojshme të diskutohet derisa kusht për shqyrtim të pretendimeve është që të jetë kërkesa e afatshme. I propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK-së dhe të hedhet poshtë ankesa e OE ankues.

Në vazhdim fjala iu dha z. Vertopi i cili deklaroj: Kërkojmë nga paneli të respektoj rregullat për parashtrim të ankesave sepse kërkesa për rishqyrtim është parashtruar në pajtim me rregullat në fuqi.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në

procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, pasi që ka analizuar shkresat e këtij aktiviteti të prokurimit sqaron që OE ankues pas pranimi të letrës standarde të tenderuesit të eliminuar me datë 04.07.2018 (konfirmimi për datën e dërgimit të letrës standarde për tenderuesin e eliminuar është pranuar përmes postës elektronike nga AK), ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 17.07.2018. Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues (AK) ka vendosur që të refuzoj Kërkesën për rishqyrtim e OE “NP SPORTING” me seli në Prizren me datë 17.07.2018 pasi që Kërkesa është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor sipas nenit 4 të Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave .

Paneli shqyrtues, konstaton se Kërkesa për rishqyrtim e OE ankues “NP SPORTING”, e dërguar pranë AK është e jashtafatshme, pasi që data e njoftimit te OE ankues ka qenë me 04.07.2018 dhe Kërkesa për rishqyrtim ka qenë me datë 17.04.2018 e që i bie në ditën e 13-të (trembëdhjetë) Sipas dispozitave të LPP dhe RrUOPP, kalkulimi i afateve kohore fillon me ditën zero nga pranimi i vendimit të AK-së, e që në rastin konkret dita zero është ditë e mërkurë e datës 04.07.2018 si ditë e dërgimit të letrës standarde ndërsa dita e dërgimit të Kërkesës për rishqyrtim pranë AK është ditë e mërkurë e datës 17.07.2018.

Paneli shqyrtues me poshtë jep sqarim rreth rrjedhës se parashtrimit te ankesës se OE ankues tek autoriteti kontraktues:

Ditët Data Dita / Numërimi

E mërkurë - Data e dërgimit të letrës standarde tek OE 04.07.2018 0

E enjte 05.07.2018 1

E premte 06.07.2018 2

E shtunë 07.07.2018 3

E diele 08.07.2018 4

E hënë – Data e fundit e lejuar për parashtrim të Kërkesës për rishqyrtim 09.07.2018 5

E martë 10.07.2018 6

E mërkurë 11.07.2018 7

E enjte 12.07.2018 8

E premte 13.07.2018 9

E shtunë 14.07.2018 10

E hënë 15.07.2018 11

E martë 16.07.2018 12

E mërkurë - Data e Kërkesës për rishqyrtim nga OE 17.07.2018 13

Andaj nga sqarimet dhëna si me lart, konstatohet se dita e fundit për parashtrim të Kërkesës për rishqyrtim ka qenë data 09.07.2018 ditë e hënë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Komuna Prishtinë

1x1 OE - NT "SPORTING" - Prizren

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.